



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.423/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Violeta Husaj Rugova - kryesues, Hajriz Hoti dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës për Raundin e Dytë për Kryetar Komune që do janë mbajtur më datë 09.11.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.423/2025, e datës 09.11.2025, parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës për Raundin e Dytë për Kryetar Komune që janë mbajtur më datë 09.11.2025.

A r s y e t i m

Me datë 09.11.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën thekson se më datë më datën 08.11.2025, aktivistë të qendrës së Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Gjakovë kanë dëgjuar në një transmetim të tubimit elektorale të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në qytetin e Gjakovës, që kandidati për Kryetar të Komunës, z. Ardian Gjini, në fjalimin e tij para qytetarëve ka deklaruar ndër të tjera: "Shumë të rinj sot nuk e dinë se çka do të thotë fjala Dangall. Meqenëse ka plot që nuk e dinë, po iu shpjegoj. Dangallat janë dy llojesh, por në total dangallat kanë qenë ata njerëz që s'iu ka shku kurgjo për dore, që çka kanë marrë me rregullu, e kanë prishë. Me marrë me ndreqë diçka, e kanë thy. Ama, një pjesë tjetër e dangallave, janë ata që i kanë shku mjeshtrit ngat e tanë kohën kanë nejt tu i folë. 'Nuk bohet qashtu', 'duhesh me shtrengu pak ma shume', *t'çoje pak ma nalt*', veç me fola kanë dite. Prova:

<https://www.youtube.com/watch?v=QRfrDROL4sM>

Ky fjalim, i mbajtur publikisht gjatë fushatës zgjedhore, përmban gjuhë fyese, denigruese dhe nxitëse ndaj kundërshtarëve politikë, duke i përshkruar ata si "dangalla që nuku ka shku kurgjo për dore" dhe si njerëz "që i prishin gjërat që marrin me ndreqë)". Këto shprehje përbëjnë ofendim të drejtpërdrejtë dhe përpjekje për t'i paraqitur kundërshtarët si të paafte, të paditur dhe të dëmshëm, gjë që synon nxitjen e përbuzjes dhe përçarjes politike. Ky veprim përbën shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, i cili ndalon përdorimin e gjuhës së papërshtatshme, fyese, shpifëse ose nxitëse të urrejtjes ndaj kundër kandidatëve dhe subjekteve të tjera politike. Në bazë të këtyre rrethanave, kërkohet që PZAP të konstatojë se kandidati Ardian Gjini ka bërë shkelje të dispozitave që ndalojnë gjuhën fyese gjatë fushatës, dhe të shqiptojë ndaj subjektit përgjegjës sanksionin e paraparë me nenin 9 të Rregullores Nr. 07/2024.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik AAK ka kundërshtuar pretendimet në ankesë me arsyetimin se nuk kemi vepruar në kundërshtim me ligjet dhe rregullat që rregullojnë aktivitetet zgjedhore. Subjekti politik AAK, nëpërmjet kësaj përgjigjeje ndaj ankesës, kundërshton në tërësi pretendimet subjektit politik LVV, duke i konsideruar fillimisht ato të pabazuara e të pa qarta, por edhe duke e vënë në dyshim afatshmërinë e kësaj ankese.

Konsiderojmë se jo vetëm pjesët e shkëputura nga parashtuesi i ankesës, por, po të analizohet edhe e tërë paraqitja e z. Gjini në emisionin në fjalë, nuk mund të konstatohet asgjë tjetër përveç gjuhës së pastër politike që përbën shembull të demokracisë zgjedhore.

Parashtuesi i ankesës është përpjekë ti interpretojë pakënaqësitë e kritikave të z. Gjini në raport me programet zgjedhore të kundërshtarëve politik si gjuhë përçarëse. Në thelb deklarimi i z. Gjini që ka paraqitur objektin e kësaj ankese ka qenë në kuadër të diskursit të tij për të shprehur pazotësinë e palës kundërshtare për të qeverisur qytetin e Gjakovës, e në asnjë moment krijimi apo nxitja e ndonjë përçarje midis qytetarëve të Gjakovës.

Shfrytëzimi i një të drejte kushtetuese e Cila është liria e shprehjes, nuk paraqet bazë për ankesë dhe nuk i kontribuon demokracisë zgjedhore, përkundrazi, paraqet vullnet jo të mirë të parashtuesit të ankesës për ta dëmtuar atë. Po ashtu shtojmë faktin se parashtuesi i ankesës ka dështuar ta argumentojë e provojë se deklarimi i z. Gjini, ka qenë i drejtuar për dikë në veçanti nga subjekti politik LVV.

Andaj, pas analizimit të rrethanave të rastit konkret, i propozojmë shqyrtuesit të kësaj ankese, ta hedhë të njëjtën poshtë si të palejueshme, apo në rastin më të pa volitshëm të njëjtën ta refuzojë si të pa bazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet-fjalët e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës -së, në të cilin parashihet që: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose*

provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Paneli vlerësoi se, janë të pabazuara pretendimet ankimore të parashtresit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar se kandidati për Kryetar të Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, në fjalimin e tij para qytetarëve ka deklaruar ndër të tjera: *"Shumë të rinj sot nuk e dinë se çka do të thotë fjala Dangall. Meqenëse ka plot që nuk e dinë, po iu shpjegoj. Dangallat janë dy llojesh, por në total dangallat kanë qenë ata njerëz që s'iu ka shku kurgjo për dore, që çka kanë marrë me rregullu, e kanë prishë. Me marrë me ndreqë diçka, e kanë thy. Ama, një pjesë tjetër e dangallave, janë ata që i kanë shku mjeshtrit ngat e tanë kohën kanë nejt tu i folë. 'Nuk bohet qashtu', 'duhesh me shtrengu pak ma shume', t'çoje pak ma nalt', veç me fola kanë dite.*

Paneli i vlerësoj se janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në deklaratën e kandidatit për Kryetar të Komunës, Ardian Gjini nga subjekti politik AAK, shprehja e përdorur **"dangall"**, sipas vlerësimit të Panelit, nuk përbën nxitje për dhunë apo provokim për dhunë ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë, apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, të njëjtat janë vlerësime politike dhe qëndrime të shprehura në kuadër të fushatës zgjedhore dhe me këtë rast paneli nuk ka gjetur se janë shkelur rregullat zgjedhore në dëm të ndonjë subjekti politik e aq më tepër këto shprehje nuk i janë drejtuar në emër të ndonjë personi konkret. Paneli nuk mund të vendos duke nënkuptuar personin apo personave që u është drejtuar, nga se bazuar në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, në mënyrë decitive thuhet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Paneli, bazuar në të lartcekurat vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtresi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.423/2025, datë 10.11.2025

Kryesues i Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.